



Pranuar / Dorezuar Prilimeno / Predato Received / Delivety	16.08.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prllog Appendix	Sasia Kolicima Quantity
SKIMSHICK	4767/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 630/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.630/2022 të datës 18.07.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi rr. kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 16.08.2022, në mënyrë unanime mori këtë;

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.630/2022 e datës 18.07.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën “Zyrtare e Financave”, në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e protokolluar me datë 18.07.2022, me numër 4171/2022, me pretendimin kundër përgjigjes në kërkesë për ngritje në detyrë të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullos Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 25.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, ndërsa kjo e fundit me datë 04.08.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokoll 4537/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. protokoll 4171/2022 të datës 18.07.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga D.H. për ankesa.kpmshek@rks-gov.net i datës 18.07.2022;

E-mail nga SH.S. për D.H. i datës 18.07.2022; E-mail nga D.H për A.P. i datës 14.07.2022; E-mail nga SH.S. për D.H. i datës 17.06.2022; E-mail nga A.I për SH.S i datës 02.06.2022; E-mail nga D.H. për SH.S. i datës 31.05.2022; E-mail nga SH.S. për D.H. i datës 27.05.2022; E-mail nga D.H. për SH.S. i datës



27.05.2022; Kërkesë për ngritje në detyrë e datës 27.05.2022; Përgjigje në kërkesë për ngritje në detyrë e datës 17.06.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 25.07.2022; Përgjigje në ankesë e datës 04.08.2022; Vërtetim i Punës i datës 11.01.2010; Ofertë pune për angazhim si kontratë individuale i datës 21.12.2007; Kontratë individuale e datës 08.02.2008; Kontratë Pune e datës 30.12.2008; Amandamentim Ndryshimi Kontratës Zgjatja e angazhimit i datës 11.06.2009; Aneks kontratë i datës 28.09.2009; Kontrata e Punës e datës 11.01.2010; Kontratë e Marrëdhënies së Punës e D.H. i datës 01.01.2010; Kontratë e Marrëdhënies së Punës e D.H. i datës 01.01.2011; Akt Emërimi i D.H. i datës 11.01.2012; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i D.H. i datës 08.01.2013; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i D.H. i datës 03.08.2015; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i D.H. i datës 08.08.2018; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i D.H. i datës 11.01.2021; Lista për verifikimin e përdoruesve të SIMFK-së me nr. protokolli 342 e datës 29.06.2018; Lista e përdoruesve me qasje të lejuara nga ana juaj në SIMFK për vitin 2019, me qëllim të ri-konfirmimit të të drejtave apo ndryshimit të tyre në SIMFK 2020; Lista e zyrtarëve të AKKVP-së për qasje në SIMFK 2020 e datës 08.01.2020; Vendim me Ref.Nr.00795/21/shs i datës 05.10.2021; Vendim Ref.nr. 00421/21/kg i datës 24.05.2021; Vendim Ref.nr. 00420/21/kg i datës 24.05.2021; Kërkesë për emërim të përkohshëm me ushtrues detyre të pozitës vakante të Zyrtarit të Lartë Financiar/Zyrtarit Shpenzues i datës 22.01.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i D.H. i datës 29.01.2021; Plani individual i trajnimit i datës 29.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike i D.H. i datës 28.01.2022; Plani individual i trajnimit i datës 28.01.2022; Kërkesë për ngritje në detyrë e datës 27.05.2022; E-mail nga SH.S. për A.I. i datës 02.06.2022; E-mail nga A.I. për SH.S. i datës 02.06.2022; E-mail nga D.H. për SH.S. i datës 31.05.2022; E-mail nga SH.S. për D.H. i datës 27.05.2022; E-mail nga D.H. për SH.S. i datës 27.05.2022; Përgjigjeje në kërkesë për ngritje në detyrë e datës 17.06.2022; E-mail nga D.H. për SH.S. i datës 21.06.2022; E-mail nga SH.S. për D.H. i datës 17.06.2022; Ankesë kundër përgjigjes në kërkesë e datës 14.07.2022; E-mail nga SH.S. për D.H. i datës 18.07.2022; E-mail nga D.H. për A.P i datës 14.07.2022; E-mail nga SH.S. për D.H. i datës 17.06.2022; Formulari i planit individual të personelit (FPIP) i vitit 2022; Parashikimi i pozitave të reja ½ faqe; Mënyra e përmbushjes së planifikimit; Plani vjetor i trajnimeve; Analiza për zhvillimin profesional dhe nevojat e trajnimit; Klasifikimi i pozitave profesionale nga MAP/DMZP; E-mail nga SH.S. për B.D. i datës 23.05.2022; E-mail nga SH.S. për B.D. i datës 13.04.2022; E-mail nga I.Ll për SH.S. i datës 05.04.2022; E-mail nga SH.S. për SH.L. i datës 04.04.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtuara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, ***është e pa bazuar sepse:***

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesja është e sistemuar në pozitën “Zyrtare e Financave” sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 11.01.2021 në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Ankuesja në bazë të shkresave të lëndës më datë 27.05.2022 ka bërë kërkesë për ngritje në detyrë tek Zv. Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Ndërsa i njëjti me datë 17.06.2022 e ka njoftuar ankuesen se Agjencia nuk mund të bëjë rekrutim pa hartuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Strukturës Organizative sipas ligjit Nr.06/L114 për Zyrtarët Publik.

Ankuesja brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër përgjigjes në kërkesë të datës 17.06.2022 për ngritje në detyrë të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke ju referuar dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës përkatësisht nenit 38 paragrafit 1 dhe 2 , konstaton se

fillimisht plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nën paragrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji” si dhe nenit 39 paragrafit 1, 2 dhe 3 i Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës i cili përcakton se: **1 Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë. 2 Mund të aplikojnë për ngritje në detyrë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vetëm nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, në marrëdhënie pune në të njëjtin apo në çdo institucion tjetër të Shërbimit Civil, nëse plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Në procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese mund të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë profesionale të konfirmuar sipas nenit 37 të këtij ligji. 3 . Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë, si dhe Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës Kosovës përkatësisht nenit 52 i cili përcakton se: **1.Në rastet kur një pozitë e lirë në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, pozita hapet për të plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë. 2.Ngritja në detyrë është procedurë konkurruese. Konkurimi organizohet për një pozitë të lirë. 3.Konkurimi për ngritjen në detyrë është i mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të një kategorie më të ulët të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil,** dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesja në momentin e parashtrimin të kërkesës për ngritje në detyrë ka qene e sistemuar në pozitën “Zyrtare e Financave” sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 11.01.2021 në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, vlerëson se organi i punësimit, me rastin e përgjigjes se datës 17.06.2022, ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartpërmendura ligjore në fuqi, sepse në rastin konkret organi i punësimit e ka njoftuar ankuesen se ngritja në detyrë nuk mund të bëhet pa procedure të rekrutimit dhe po ashtu institucioni nuk mund të bëjë rekrutim pa hartuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës . Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të mandatit kushtetues dhe ligjor, për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve dhe veprimeve të organeve të administratës, konstaton se avancimi në karrierë në shërbimin civil duhet të bëhet në mënyrë transparente, të drejtë, të unifikuar, objektive dhe në bazë të meritës së kandidatëve përkatës. Nëpunësit civil ngritën në pozitë në bazë të një procedure të rregulluar dhe vetëm nëse i plotësojnë kushtet specifike të përcaktuara në aktet përkatëse ligjore dhe në bazë të meritës, prandaj pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar sepse ngritja në pozitë nuk bëhet në mënyrë automatike, por vetëm pas një periudhe të caktuar kohore dhe në bazë të procedurës së rekrutimit, gjegjësisht institucionet me rastin e ngritjes në detyrë të nëpunësve civile duhet të respektojnë dispozitat ligjore, rregullat dhe parimet sipas legjislacionit në fuqi.**

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ka analizuar dispozitat e Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenit 3 paragrafit 1 ku është përcaktuar se: **1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil,** ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: „ **Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës**” dhe rrjedhimisht ka konstatuar se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Në kuptim të kësaj baze ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 11.01.2021, në pozitën “Zyrtare e Financave”, dhe e njëjta realizon pagën në vlerën e përcaktuar në bazë të Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të lartëcekur. Andaj, meqenëse Kolegji në provat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë kontratë apo akt tjetër administrativ të organit të punësimit pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.630/2022

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretarisë Ekzekutive në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
- Arkivit të KPMSHCK-së;